



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ANALIZA E TREGUT TË DRITHËRAVE 2021-2023



**DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE
BUJQËSORE**

Analiza e tregut të drithërave 2021-2023

Gusht, 2025

Përmbajtja

Lista e tabelave.....	3
Lista e figurave.....	4
Lista e shkurtesave	6
Hyrja	7
Metodologjia.....	8
Përmbledhje	9
1 Prodhimtaria e sektorit të drithërave	11
1.1 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave	11
1.2 Drithërat më të kultivuara.....	12
1.2.1 Gruri	12
1.2.2 Misri	13
1.2.3 Tërshëra	13
1.2.4 Elb dhe elb birre.....	14
1.2.5 Thekër	14
1.2.6 Drithëra të tjera kokërr.....	15
2 Tregtia për sektorin e drithërave	16
2.1 Eksporti dhe importi i drithërave.....	19
2.1.1 Eksporti dhe importi i grurit.....	21
2.1.2 Eksporti dhe importi i misrit.....	25
2.1.3 Eksporti dhe importi i elbit	29
2.1.4 Eksporti dhe importi i tërshërës	33
2.1.5 Eksporti dhe importi i thekrës	36
3 Çmimet e drithërave	39
3.1 Çmimi për grurë.....	39
3.2 Çmimi për misër.....	39
3.3 Çmimi për elb.....	40
3.4 Çmimi për thekër.....	40
3.5 Çmimi për tërshërë.....	41
4 Mbështetja direkte për sektorin e drithërave.....	42
4.1 Pagesa direkte për grurë.....	44
4.2 Pagesat direkte për grurë kg	45
4.3 Pagesa direkte për farë gruri.....	46
4.4 Pagesa direkte për farë gruri për kg.....	47
4.5 Pagesa direkte për misër.....	47
4.6 Pagesa direkte për elb	48
4.7 Pagesa direkte për thekër	49
4.8 Pagesa direkte për tërshërë	50
5 Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi	52
5.1 Plotësimi i nevojave vendore me drithëra.....	52
5.1.1 Plotësimi i nevojave vendore për drithërave më të kultivuara	52
5.2 Konsumi për kokë banori	55
Konkluzionet	56
Shtojca 1	57

Lista e tabelave

Tabela 1:	Sipërfaqja e drithërave 2021-2023, në ha	11
Tabela 2:	Prodhimi i drithërave 2021-2023, në tonë.....	11
Tabela 3:	Rendimenti 2021-2023, në tonë/ha	12
Tabela 4:	Eksporti dhe importi për kodet doganore 10 dhe 11	16
Tabela 5:	Eksporti i kulturave kryesore në grupin e drithërave	19
Tabela 6:	Importi i kulturave kryesore në grupin e drithërave.....	20
Tabela 7:	Eksporti dhe importi i grurit.....	22
Tabela 8:	Eksporti dhe importi i misrit.....	26
Tabela 9:	Eksporti dhe importi i elbit	30
Tabela 10:	Eksporti dhe importi i tërshërës	33
Tabela 11:	Eksporti dhe importi i thekrës	36
Tabela 12:	Çmimet e drithërave 2021-2023	39
Tabela 13:	Pagesat direkte për sektorin e drithërave 2021-2023	42
Tabela 14:	Pagesa direkte për grurë, 2021-2023.....	44
Tabela 15:	Pagesa direkte për grurë kg, 2021-2023	45
Tabela 16:	Pagesa direkte për farë gruri, 2021-2023.....	46
Tabela 17:	Pagesa direkte për farë gruri për kg, 2021-2023	47
Tabela 18:	Pagesa direkte për misër, 2021-2023	48
Tabela 19:	Pagesa direkte për elb, 2021-2023.....	48
Tabela 20:	Pagesa direkte për thekër, 2021-2023	49
Tabela 21:	Pagesa direkte për tërshërë, 2021-2023	50
Tabela 21:	Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për grurë.....	57
Tabela 22:	Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për misër.....	57
Tabela 23:	Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për elb	58
Tabela 24:	Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për tërshërë	58
Tabela 25:	Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për thekër	58

Lista e figurave

Figura 1:	Pjesëmarrja e kulturave në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me drithëra	12
Figura 2:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i grurit	13
Figura 3:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i misrit	13
Figura 4:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i tërshërës.....	14
Figura 5:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i elbit dhe elb birre.....	14
Figura 6:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i thekrës.....	15
Figura 7:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave kokërr.....	15
Figura 8:	Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të drithërave në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (01-24) në %	17
Figura 9:	Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të produkteve të industrisë bluajtëse në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24) në %	17
Figura 10:	Importi, eksporti dhe bilanci tregtar për drithëra (kodi doganor 10), vlera në ‘000 €.....	18
Figura 11:	Importi, eksporti dhe bilanci tregtar për produktet e industrisë bluajtëse (kodi doganor 11), vlera në ‘000 €	18
Figura 12:	Vlera e eksportit të drithërave, në %	20
Figura 13:	Vlera e importit të drithërave, në %	21
Figura 14:	Eksporti i grurit 2021-2023	22
Figura 15:	Eksporti i grurit sipas muajve, në ‘000 €.....	23
Figura 16:	Eksporti i grurit sipas shteteve	23
Figura 17:	Importi i grurit 2021-2023.....	24
Figura 18:	Importi i grurit sipas muajve në, ‘000 €	24
Figura 19:	Importi i grurit sipas shteteve.....	25
Figura 20:	Eksporti i misrit 2021-2023	26
Figura 21:	Eksporti i misrit sipas muajve, në ‘000 €	27
Figura 22:	Eksporti i misrit sipas shteteve	27
Figura 23:	Importi i misrit 2021-2023.....	28
Figura 24:	Importi i misrit sipas muajve, në ‘000 €.....	28
Figura 25:	Importi i misrit sipas shteteve	29
Figura 26:	Eksporti i elbit 2021-2023.....	30
Figura 27:	Eksporti i elbit sipas muajve, në ‘000 €	31
Figura 28:	Importi i elbit 2021-2023	31
Figura 29:	Importi i elbit sipas muajve, në ‘000 €.....	32
Figura 30:	Importi i elbit sipas shteteve	32
Figura 31:	Eksporti i tërshërës 2021-2023.....	33
Figura 32:	Eksporti i tërshërës sipas muajve, në ‘000 €	34
Figura 33:	Importi i tërshërës 2021-2023	34
Figura 34:	Importi i tërshërës sipas muajve, në ‘000 €	35
Figura 35:	Importi i tërshërës sipas shteteve	35
Figura 36:	Eksporti i thekrës 2021-2023.....	36
Figura 37:	Eksporti i thekrës sipas muajve, në ‘000 €	37

Figura 38:	Importi i thekrës 2021-2023	37
Figura 39:	Importi i thekrës sipas muajve, në '000 €	38
Figura 40:	Çmimi për grurë, 2021-2023	39
Figura 41:	Çmimi për misër, 2021-2023	40
Figura 42:	Çmimi për elb, 2021-2023	40
Figura 43:	Çmimi për thekër, 2021-2023	41
Figura 44:	Çmimi për tërshërë, 2021-2023	41
Figura 45:	Pjesëmarrja e pagesave direkte për drithëra në gjithsej shumën e pagesave direkte	43
Figura 46:	Shpërndarja e pagesave direkte sipas kulturave (%)	44
Figura 47:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për grurë	45
Figura 48:	Sasia e subvencionuar dhe shuma e paguar për grurë kg	46
Figura 49:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për farë gruri	47
Figura 50:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për misër	48
Figura 51:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për elb	49
Figura 52:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për thekër.....	50
Figura 53:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për tërshërë.....	51
Figura 54:	Furnizimi me drithëra, 2021-2023.....	52
Figura 55:	Furnizimi me grurë, 2021-2023	53
Figura 56:	Furnizimi me misër, 2021-2023	53
Figura 57:	Furnizimi me tërshërë, 2021-2023.....	54
Figura 58:	Furnizimi me elb dhe elb birre, 2021-2023	54
Figura 59:	Furnizimi me thekër, 2021-2023.....	55
Figura 61:	Konsumi i drithërave për kokë banori, 2021-2023	55

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AZhB	Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
PPD	Programi i Pagesave Direkte

Hyrja

Drithërat janë kultura bujqësore prej më të rëndësishmeve, si për nga ana ekonomike po ashtu edhe për nga ushqyeshmëria, ku vlera e prodhimeve të drithërave në botë arrin në 1,000 mld. €. ¹ Disa lloje të drithërave kanë mijëra varietete të ndryshme të cilat përdoren si ushqim kryesor për njeriun dhe për kafshët. Disa nga varietetet e drithërave më të njohura përdoren për bukë, pasta, ëmbëlsira, biskota dhe miell. Kurse një pjesë e drithërave përdoren edhe për industrinë e prodhimit të niseshtesë, glutenit, alkoolit dhe produkteve të tjera.

Drithërat në Kosovë mbështeten përmes pagesave direkte/subvencioneve për sipërfaqet e mbjella, për sasi të prodhimit (gruri dhe fara e grurit) dhe për inpute (naftë dhe pleh), ku përmes subvencioneve synohet të mbështeten fermerët për rritje të sipërfaqeve, rritje të rendimentit, përmirësim të cilësisë, furnizim të plotë të tregut, si dhe kontroll të çmimeve. Analiza e tregut për kultura të drithërave fokusohet komplet te zhvillimet e ndodhura në mënyrë të vazhdueshme që të shihet dhe të paraqitet efekti i këtyre politikave mbështetëse, por edhe të paraqiten edhe nevojat e tanishme për mbështetjen e kulturave të caktuara.

Sipërfaqja e kultivuar me drithëra ka mbetur e qëndrueshme gjatë periudhës '21-'23, duke treguar një rritje të lehtë në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak. Nga gjithsej sipërfaqja me drithëra, dominojnë kultura e grurit dhe misrit. Pavarësisht stabilitetit në sipërfaqen e kultivuar, prodhimi dhe rendimenti i drithërave në vitin 2023, paraqitet me një rënie të lehtë, si rezultat i kushteve të pafavorshme klimatike dhe disa faktorëve të tjerë.

Prodhimi i drithërave në Kosovë varësisht prej kulturës është i dominuar nga përdorimi për konsum njerëzor (gruri) apo përdorimi si ushqim për kafshë (të gjitha drithërat me përjashtim të grurit). Analiza e tregut të drithërave për periudhën e fundit tre vjeçare '21-'23, është përgatitur për të identifikuar dhe vlerësuar kërkesën dhe ofertën nëpërmjet sasisë, çmimeve, ndryshimeve të prodhimit, sipërfaqet e mbjella me drithëra, por edhe lidhjet e ndërsjella që ka Kosova me vendet e tjera në tregtimin e drithërave, sa është e varur nga importi dhe si qëndron në aspektin e plotësimit të nevojave vendore për konsum.

¹ <https://www.statista.com/outlook/io/agriculture/cereals/worldwide?currency=EUR>

Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është që në mënyrë të përmbledhur përmes të dhënave statistikore të paraqiten zhvillimet në sektorin e drithërave për periudhën '21-'23, me fokus të veçantë në kulturat që kultivohen më së shumti në Kosovë.

Burimet e të dhënave të përdorura në këtë analizë janë: të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (të dhënat për sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e kulturave të drithërave, të dhënat për numrin e popullsisë, si dhe të dhënat për tregtinë e jashtme që burim primar është Dogana e Kosovës), të dhënat nga DAESB lidhur me çmimet e kulturave bujqësore dhe të dhënat nga AZhB-ës (të dhënat për pagesa direkte). Të gjitha këto të dhëna janë përpunuar dhe janë bërë kalkulime nga DAESB. Analiza përmban pesë kapituj kryesor me nënkapituj përkatës. Më poshtë është paraqitur përmbajtja e detajuar e secilit kapitull të kësaj analize:

Kapitulli 1: Prodhimtaria e sektorit të drithërave. Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat lidhur me sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e drithërave ku analizohet pjesëmarrja e tyre si dhe ndryshimi i ndodhur mes viteve, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar kulturave që kultivohen në sipërfaqe më të madhe në Kosovë.

Kapitulli 2: Tregtia për sektorin e drithërave. Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat lidhur me tregtinë e jashtme të drithërave, ku analizohet gjithsej eksporti dhe importi, sipas muajve dhe sipas shteteve, ku vëmendje e veçantë prapë i është kushtuar kulturave që kultivohen në sipërfaqe më të madhe në Kosovë.

Kapitulli 3: Çmimet e drithërave. Në këtë kapitull janë të paraqitura çmimet për kulturat më të kultivuara në Kosovë si çmime mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë.

Kapitulli 4: Mbështetja për sektorin e drithërave. Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat e pagesave direkte/subvencioneve për sektorin e drithërave, duke përfshirë mbështetjen direkte për hektarë të kultivuar, për sasi të prodhuar (grurë dhe farë gruri) si dhe për inpute (pleh dhe naftë), ku mbështetja për pleh ka filluar në vitin 2022 e përfshirë në sipërfaqen e kultivuar, kurse në vitin 2023, mbështetja është bërë bazuar në faturat e blerjes së plehut. Këtu është analizuar edhe numri i aplikuesve, numri i përfituesve, numri i njësive të subvencionuara, pagesa për njësi të subvencionuar si dhe gjithsej shuma e subvencionimit.

Kapitulli 5: Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi. Në këtë kapitull bëhet një ndërlidhje e të gjitha të dhënave në kapitujt paraprak për të pasqyruar furnizimin me drithëra, duke përfshirë prodhimin vendor, importin dhe eksportin për të pasqyruar shkallën e plotësimit të nevojave për konsum me prodhim vendor si dhe konsumin për kokë banori.

Analiza përfundon me konkluzione ku në bazë të analizës së të dhënave paraqiten konkluzionet lidhur me tregtinë e drithërave në Kosovë.

Përmbledhje

Në Republikën e Kosovës përgjatë vitit 2023, është kultivuar sipërfaqe e drithërave gjithsej 124,681 ha, nga të cilat janë prodhuar gjithsej 477,149 tonë me drithëra. Sipërfaqja me drithëra në periudhën '21-'23, shënoi rritje në vazhdimësi por që kjo rritje duket që nuk u përcjell edhe tek prodhimi, ku në vitin 2023, u pasua me ulje prej 8% në raport me vitin 2022, e gjitha si pasojë e rënies së rendimentit tek të gjitha drithërat. Janë 5 kultura të drithërave që dominuan (gruri, misri, tërshëra, elbi dhe thekra) me gjithsej sipërfaqe prej 99.9%, dhe po aq me prodhim të drithërave.

Për përmbushjen e nevojave vendore për konsumin e drithërave, vendi vazhdon të importoj drithëra, mirëpo ato edhe eksportohen, por në sasi dhe vlerë më të vogël, duke rezultuar me një bilanc tregtar negativ. Eksportet gjatë vitit 2023, dominohen nga: gruri dhe misri, me 96% të vlerës të totalit të eksporteve, pasuar nga të gjitha kulturat e tjera marrë së bashku me një pjesëmarrje prej 4%.

Importi i drithërave gjatë vitit 2023, ishte 54.5 mil. €, ku vlerën më të madhe të importit sipas kulturës në importet e përgjithshme të drithërave kishte kultura e grurit, për vitin 2021, me pjesëmarrje prej 57.8%, pasuar me një ngritje në vitin 2022 në 66.4% dhe për vitin 2023 përqindja e pjesëmarrjes kishte arritur në 65.9%. Sa i përket kulturës së misrit kemi rënie të përqindjes së pjesëmarrjes në importin e përgjithshëm të drithërave, nga 24.8% sa ishte për vitin 2021, vazhdoi në vitin 2022 me 21.4%, dhe me 16.7% për vitin 2023. Tek kultura e elbit importi në importet e përgjithshme të drithërave për vitet 2021 dhe 2023 kishte pjesëmarrje të përafërta me 5%, kurse 2.5% ishte në vitin 2022. Kategoritë të tjera tek të gjitha drithërat mesatarja e pjesëmarrjes së importit ishte 11%.

Viti 2023 në raport me vitin 2022, u karakterizua me ulje të çmimeve të drithërave më të kultivuara në Kosovë. Rritje të çmimeve pati vetëm tek kultura e elbit të çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, kurse kulturat tjera kishin rënie të çmimeve. Ndërsa rënien më të lartën të çmimit e kishte kultura e thekrës me 58%, misri me 41%, tërshëra 38% dhe gruri me 31%.

Spektori i drithërave mbështetet përmes Programit të Pagesave Direkte. Mbështetja për kulturat e drithërave kryesisht realizohet për sipërfaqet e mbjella, për sasi të prodhimit dhe për inpute (naftë dhe pleh). Gjithsej shuma e pagesave direkte për drithëra ishte 25.9 mil. €, ku pjesa më e madhe përkatësisht 63% ishte për grurin, pasuar nga misri me 35%, dhe kulturat tjera me 2%.

Pagesa mbështetëse për sipërfaqe është e ndryshme varësisht prej kulturës, më e larta është për farë gruri me 304 €/ha, misër 229 €/ha, ndërsa kulturat të tjera si: gruri, elb, thekër, tërshërë janë të ngjashme dhe mbështeten për sipërfaqe me 204 €/ha. Në rastin e grurit për kg pagesa në vitin 2023 ishte 0.03 €/kg, për farë gruri ishte 0.04 €/kg, kurse mbështetja për naftë

ishte 54 €/ha, apo 150 litër për ha, nga 0.36 €/litër. Për pleh mbështetja ishte me 150 €/ha tek gruri dhe farë gruri, kurse tek misri mbështetja ishte me 100 €/ha.

Plotësimi i nevojave vendore me kultura të drithërave përgjatë periudhës '21-'23, ishte në nivelin mesatar prej 74%, ku importi është dukshëm më i madh se eksporti. Prodhimi vendor i drithërave nuk plotëson gjitha nevojat vendore të popullsisë për konsum apo edhe nevojat e përdorimit të drithërave si ushqim për kafshë, andaj pjesa tjetër plotësohet nga prodhimet e importit.

Në vitin 2023, prodhimi vendor i drithërave ishte 477,149 tonë, ndërsa u importuan 207,042 tonë, eksporti ishte 5,522 tonë, ku rezulton me përqindje të plotësimit të nevojave vendore prej 70%, 6 pikë të përqindjes më pak se në vitin 2022, si dhe 5 pikë të përqindjes më pak se viti 2021. Konsumi i drithërave për vitin 2023, ishte 214 kg për kokë banori.

1 Prodhimtaria e sektorit të drithërave

1.1 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave

Në Kosovë në vitin 2023, gjithsej sipërfaqja me drithëra ishte 124,681 ha, në krahasim me vitin paraprak kemi një rritje të vogël të sipërfaqes prej 0.05%. Sipërfaqja e drithërave në përgjithësi shënoi rritje përveç kulturës së elbit ku në vitin 2023, ka pasur rënie prej 2.4%. Në gjithsej sipërfaqen e drithërave, gruri dhe misri ishin dy kulturat që dominuan mbjelljet, ku sa i përket pjesëmarrjes kishin gjithsej 96%.

Tabela 1: Sipërfaqja e drithërave 2021-2023, në ha

Sipërfaqja	2021	2022	2023	Pjesëmarrja në % (2023)	Ndryshimi 2023/2022 në %
Grurë	79,970	79,984	80,025	64.2	0.1
Misër	39,710	39,797	39,844	32.0	0.1
Tërshërë	2,030	2,045	2,061	1.7	0.8
Elb dhe elb birre	2,060	2,067	2,017	1.6	-2.4
Thekër	555	567	574	0.5	1.2
Drithëra të tjera kokërr	153	158	160	0.1	1.3
Gjithsej sipërfaqja me drithëra	124,477	124,618	124,681	100.0	0.1

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21, '22, '23)

Në vitin 2023, në gjithsej sipërfaqen prej 124,681 ha, janë prodhuar 477,149 tonë me drithëra. Në përgjithësi sektori i drithërave për vitin 2023, ka pasur rënie të prodhimit me 8%, në krahasim me vitin 2022, kjo është si rezultat i rënies së rendimentit tek të gjitha kulturat e drithërave, pavarësisht që kemi pasur një rritje të vogël tek sipërfaqja e të gjitha kulturave me përjashtim të elbit që kishte rënie në sipërfaqe.

Tabela 2: Prodhimi i drithërave 2021-2023, në tonë

Prodhimi	2021	2022	2023	Pjesëmarrja në % (2023)	Ndryshimi 2023/2022 në %
Grurë	322,018	330,913	303,496	63.6	-8.3
Misër	170,393	175,226	161,667	33.9	-7.7
Tërshërë	4,500	4,715	4,554	1.0	-3.4
Elb dhe elb birre	5,610	5,882	5,487	1.1	-6.7
Thekër	1,409	1,492	1,462	0.3	-2.0
Drithëra të tjera kokërr	441	496	483	0.1	-2.7
Gjithsej sipërfaqja me drithëra	504,371	518,724	477,149	100.0	-8.0

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21, '22, '23)

Rendimenti tek të gjitha kulturat e drithërave ka shënuar rënie në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022, ku rënia në rendiment ka dalluar nga 3% tek thekra, në 8.3% tek gruri, i cili së bashku me misrin që kishte rënie prej 7.8% në rendiment, ishin dy kulturat që shënuan rënien më të madhe.

Tabela 3: Rendimenti 2021-2023, në tonë/ha


Rendimenti	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023/2022 në %
Grurë	4.03	4.14	3.79	-8.3
Misër	4.29	4.40	4.06	-7.8
Tërshërë	2.22	2.31	2.21	-4.2
Elb dhe elb birre	2.72	2.85	2.72	-4.4
Thekër	2.54	2.63	2.55	-3.1
Drithëra të tjera kokërr	2.89	3.14	3.02	-3.9

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21, '22, '23)

1.2 Drithërat më të kultivuara

Sa i përket pjesëmarrjes së kulturave të kultivuara në grupin e drithërave, nuk ka pasur ndryshim të theksuar në tre vitet e fundit. Nëse krahasojmë vitin 2021 me vitin 2023, tek gruri dhe drithërat tjera kokërr, nuk ka pasur fare ndryshim, ndërsa tek misri, tërshëra, elbi dhe thekra ndryshimi është me 0.1%.

Figura 1: Pjesëmarrja e kulturave në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me drithëra




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.2.1 Gruri

Në vitin 2023 në sipërfaqen prej 80,025 ha me drithëra, gruri ka pasur një rritje të vogël me 0.01%, për dallim me vitin 2022, ku sipërfaqja ishte 79,984 ha, prodhimi tek gruri ka pësuar rënie me 8%, kjo vjen si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe faktorëve të tjerë (mos plotësimi i masave agroteknike nga fermerët), ku si rrjedhojë kemi rënie të rendimentit të të gjitha kulturat.

Figura 2: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i grurit




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.2.2 Misri

Sipërfaqja e misrit në vitin 2023 ishte 39,844 ha, që në krahasim me vitin 2022 ishte për 0.01% më e lartë. Rendimenti mesatar për periudhën '21-'23 ishte 4.3 tonë/ha, duke realizuar prodhimtari mesatare për periudhën '21-'23, prej 169 mijë tonë.

Figura 3: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i misrit




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.2.3 Tërshëra

Sipërfaqja me tërshërë prej 2,030 ha të mbjella sa ishte në vitin 2021, është rritur për 0.7% në vitin 2022, dhe ka vazhduar rritja edhe në vitin 2023 me 0.8%. Rendimenti nuk ka pasur dallim mes viteve, në vitin 2022 është vetëm 0.09 tonë/ha më i lartë krahas viteve 2021 dhe 2023. Prodhimi rezultoi me rënie në vitin 2023 për 3.4%, krahasuar me vitin 2022.

Figura 4: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i tërshërës




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.2.4 Elb dhe elb birre

Sipërfaqja mesatare me elb në periudhën '21-'23 ishte 2,048 ha, rendimenti mesatar për periudhën '21-'23, ishte 2.76 tonë për hektar dhe prodhimtaria totale për këtë periudhë rezultoi me 16,979 tonë.

Figura 5: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i elbit dhe elb birre




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.2.5 Thekër

Në vitin 2023, sipërfaqja me thekër ishte 574 ha, apo 1% më e lartë sesa në vitin 2022. Prodhimi shënoi rënie për 2%, si rezultat i rënies së rendimentit për 3%.

Figura 6: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i thekrës




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.2.6 Drithëra të tjera kokërr

Sipërfaqja me drithëra të tjera kokërr nga 153 ha, sa ishte në vitin 2021, u rrit për 3.4% në vitin 2022, dhe rritja ka vazhduar edhe në vitin 2023 me 1.3%. Prodhimi ka rezultuar me rënie gjatë vitit 2023 për 2.6%, në krahasim me vitin 2022, kjo si pasojë e rënies së rendimentit me 3.9%.

Figura 7: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave kokërr



Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2 Tregtia për sektorin e drithërave

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të dhënat e eksportit dhe importit për kodin doganor 10 (drithërat), ku është dhënë një pasqyrë e përgjithshme për këtë kategori kulturash.

Nga të dhënat e mëposhtme shihet se sasia e eksportit për kodin doganor 10, ka shënuar rritje në vitin 2023, për 34.8% pas rënies që kishte në vitin 2022 për 67.3%. Trendi i njëjtë ishte edhe tek vlera e eksportit ku viti 2023 u karakterizua me rritje të vlerës për 7.1%, pas rënies prej 40.6% që ishte në vitin 2022. Tek importi krahasuar me eksportin kemi rritje të vazhdueshme të sasisë së importuar gjatë viteve, ku rritja më e madhe ishte gjatë vitit 2023, për dallim nga rritja e vazhdueshme e sasisë, vlera e importit në vitin 2023, shënoi rënie në krahasim me vitin 2022, edhe përkundër rritjes së sasisë, e kjo si rezultat i asaj se vlera mesatare për njësi të importuar ishte më e ulët.

Eksporti i produkteve të industrisë bluajtëse në vitin 2023, shënoi rritje në krahasim me vitin 2022, si në sasi po ashtu edhe në vlerë, ku sasia është rritur për 75.6% ndërsa vlera për 47.7%. Rritja në vlerë ishte më e ulët sesa rritja në sasi për shkak të vlerës për njësi të eksportuar, që ishte më e ulët në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022. Importi i produkteve të industrisë bluajtëse në periudhën '21-'23, më i ulëti ishte në vitin 2022 kur u importuar sasia prej 22,756 tonë ndërsa më i larti në vitin 2021, me 29,096 tonë, ndërsa vlera shënoi rritje të vazhdueshme si pasojë e rritjes së vazhdueshme të vlerës për njësi të importuar, nga 0.36 €/kg sa ishte në vitin 2021, në 0.55 €/kg në vitin 2023.

Tabela 4: Eksporti dhe importi për kodet doganore 10² dhe 11³

Kodi doganor			2021	2022	2023
10. Drithërat	Eksporti	Vlera në €	504,854	299,640	321,043
		Sasia në kg	942,173	308,405	415,692
	Importi	Vlera në €	38,645,363	54,547,939	52,535,553
		Sasia në kg	146,793,642	147,107,962	182,406,947
	Eksporti	Vlera në €	1,871,582	1,304,699	1,927,347
		Sasia në kg	6,547,520	2,907,167	5,106,132
11. Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	Importi	Vlera në €	10,588,215	12,044,093	13,599,021
		Sasia në kg	29,096,458	22,755,997	24,635,121


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Pjesëmarrja e eksportit të drithërave (kodi doganor 10) në produktet bujqësore (kodet doganore 01-24) është 0.5% për vitin 2021, ndërsa për vitet '22-'23 pjesëmarrja është më e vogël. Tek importi kjo pjesëmarrje është më e lartë, konkretisht për vitin 2022, me 4.6% dhe pothuajse e njëjta pjesëmarrje me 4% ishte për vitet 2021 dhe 2023.

² Drithërat

³ Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri


Figura 8: Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të drithërave⁴ në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (01-24) në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja e eksportit të produkteve të industrisë bluajtëse (kodi doganor 11) në produktet bujqësore (kodet doganore 01-24) ishte 2% për vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 përqindja e pjesëmarrjes ishte 1%. Sa i përket importit pjesëmarrja ishte e njëjtë për tre vitet me vetëm 1%.

Figura 9: Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të produkteve të industrisë bluajtëse⁵ në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24) në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


Rritja e importit të drithërave në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 dhe rënia e njëkohësishme e eksportit ka ndikuar që vlera e bilancit tregtar të rritet nga 38 mil. € sa ishte

⁴ Kodi dyshifror doganor 10

⁵ Kodi dyshifror doganor 11

në vitin 2021, në 54 mil. € në vitin 2022, për tu pasuar pastaj me rënie në vitin 2023 në vlerë negative prej 52 mil. €.


Figura 10: Importi, eksporti dhe bilanci tregtar për drithëra (kodi doganor 10), vlera në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Bilanci tregtar për produktet e industrisë bluajtëse ka shënuar rritje të vazhdueshme në periudhën '21-'23, ku edhe pse vlera e eksportit pas një rënie në vitin 2022, në vitin 2023 u rrit, rritja në import ishte më e lartë duke rezultuar kështu në bilanc më të madh negativ që kishte vlerën 11.7 mil. €.

Figura 11: Importi, eksporti dhe bilanci tregtar për produktet e industrisë bluajtëse (kodi doganor 11), vlera në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.1 Eksporti dhe importi i drithërave

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur eksporti i drithërave në vlerë dhe sasi për periudhën '21-'23, tërshëra ishte kultura e cila nuk kishte eksport për vitin 2021 dhe për vitin 2023, ndërsa viti 2022, nuk kishte eksport të elbit dhe kjo arsyetohet për shkak të sasisë së vogël të prodhimit, ku e gjithë prodhimtaria është përdorur për të plotësuar nevojat brenda vendit.

Prej grupit të drithërave, kulturat më të eksportuara në vitin 2023, ishin: gruri, misri, elbi, dhe thekra. Këto katër kultura përbëjnë 96% të eksportit, ndërsa 4% është eksporti i disa kulturave të tjera në grupin e drithërave.

Tabela 5: Eksporti i kulturave kryesore në grupin e drithërave

Kultura	2021		2022		2023	
	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg
Grurë ⁶	2,006,282	9,398,312	1,312,843	4,034,761	1,959,075	7,162,131
Misër ⁷	187,563	201,780	186,872	100,320	193,692	90,028
Elb ⁸	24,720	60,000	0	0	12,250	25,000
Tërshërë ⁹	0	0	242	149	0	0
Thekër ¹⁰	743	750	693	700	1,040	1,050

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur kulturat të cilat janë eksportuar për periudhën '21-'23 (grurë, misër, elb), mesatarja e eksportit të grurit për këtë periudhë ishte 84%, misri me 9%, tek kultura e elbit eksport kemi një përqindje të vogël prej 1%, për vitet 2021 dhe 2023, ndërsa për vitin 2022 nuk ka pasur fare eksport të elbit.

Tek kategoria të tjera, mesatarisht me 6% pjesëmarrje të eksportit hyjnë të gjitha kulturat e drithërave të cilat nuk janë të paraqitura në figurë.

⁶ Sasia përfshinë grurin, farën e grurit dhe nën produkte të grurit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të grurit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të grurit është konvertuar në grurë përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.


⁷ Sasia përfshinë misrin, farën e misrit dhe nën produkte të misrit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të misrit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të misrit është konvertuar në misër përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

⁸ Sasia përfshinë elbin, farën e elbit dhe nën produkte të elbit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të elbit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të elbit është konvertuar në elb përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

⁹ Sasia përfshinë tërshërën dhe farën e tërshërës. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

¹⁰ Sasia përfshinë thekrën dhe farën e thekrës. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

Figura 12: Vlera e eksportit të drithërave, në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Më poshtë është paraqitur tabela e importit të drithërave në vlerë dhe sasi për periudhën '21-'23, ku kulturat më të importuara janë: gruri, misri, elbi, thekra dhe tërshëra.

Tabela 6: Importi i kulturave kryesore në grupin e drithërave

Kultura	2021		2022		2023	
	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg
Grurë ¹¹	28,454,712	121,395,271	44,233,150	124,060,427	43,612,015	160,994,280
Misër ¹²	12,233,467	47,326,770	14,279,306	41,774,261	11,060,932	41,111,505
Elb ¹³	2,432,415	7,860,694	1,698,038	4,764,119	3,337,893	6,310,167
Tërshërë ¹⁴	15,576	68,881	32,247	102,779	32,762	84,930
Thekër ¹⁵	21,229	99,494	9,325	25,000	41,947	176,130

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Më poshtë është paraqitur figura bazuar në vlerën e importit të drithërave për periudhën '21-'23 (grurë, misër, elb). Vlera më e madhe e importuar është për kulturën e grurit ku përqindja e pjesëmarrjes për vitin 2021 ishte 57.8%, duke vazhduar me ngritje në vitin 2022 në 66.4%, dhe në 65.9% pjesëmarrje në vitin 2023. Sa i përket kulturës së misrit këtu kemi rënie të përqindjes

¹¹ Sasia përfshinë grurin, farën e grurit dhe nën produkte të grurit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të grurit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të grurit është konvertuar në grurë përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

¹² Sasia përfshinë misrin, farën e misrit dhe nën produkte të misrit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të misrit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të misrit është konvertuar në misër përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

¹³ Sasia përfshinë elbin, farën e elbit dhe nën produkte të elbit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të elbit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të elbit është konvertuar në elb përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.


¹⁴ Sasia përfshinë tërshërën dhe farën e tërshërës. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

¹⁵ Sasia përfshinë thekrën dhe farën e thekrës. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

së pjesëmarrjes së misrit të importuar në raport me gjithsej drithërat dhe produktet e industrisë bluajtëse, nga 24.8% sa ishte në vitin 2021, vazhdoi në vitin 2022 me 21.4%, dhe me 16.7% pjesëmarrje për vitin 2023.

Tek kultura e elbit pjesëmarrja e importit në importet e përgjithshme të drithërave dhe produkteve të industrisë bluajtëse për vitet 2021 dhe 2023, ishte rreth 5%, kurse 2.5% në vitin 2022. Tek kategoria “Të tjera” janë paraqitur të gjitha kulturat e drithërave dhe produkteve të industrisë bluajtëse të cilat nuk janë të paraqitura në figurë dhe mesatarja e importuar e të cilave ishte 11%.

Figura 13: Vlera e importit të drithërave, në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.1.1 Eksporti dhe importi i grurit

Më poshtë është paraqitur tabela për eksport dhe import të grurit për periudhën '21-'23. Shihet se sasia e eksportit është më e vogël se sasia e importit. Mesatarja e vlerës të eksportit të grurit për periudhën '21-'23 ishte 1.76 mil. €, ndërsa vlera e importit ishte mesatarisht 38.8 mil. €.

Vlerat për njësi të eksportit të farës së grurit por edhe të miellit kishin luhatje (ulje-ngritje), mirëpo edhe vlerat e importit kishin luhatje sidomos gjatë vitit 2022, si pasojë e krizave të ndryshme në tregje ndërkombëtare.


Tabela 7: Eksporti dhe importi i grurit

		2021	2022	2023
Eksporti	Vlera në €	2,006,282	1,312,843	1,959,075
	Sasia në kg ¹⁶	9,398,312	4,034,761	7,162,131
	Vlera për njësi të farës së grurit të eksportuar (€/kg) ¹⁷	0.36	0.54	0.44
	Vlera për njësi të miellit të eksportuar (€/kg) ¹⁸	0.28	0.43	0.37
Importi	Vlera në €	28,454,712	44,233,150	43,612,015
	Sasia në kg	121,395,271	124,060,427	160,994,280
	Vlera për njësi të farës së grurit të importuar (€/kg)	0.37	0.59	0.44
	Vlera për njësi të grurit të importuar (€/kg) ¹⁹	0.22	0.33	0.25
	Vlera për njësi të miellit të importuar (€/kg)	0.31	0.50	0.46

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i grurit

Kultura e grurit, eksportet më të mëdha në sasi i kishte gjatë vitit 2021, me 9,398 tonë, gjatë vitit 2022 eksportet ishin 4,035 tonë, kurse gjatë vitit 2023 ishin 7,162 tonë. Mesatarja e vlerës për njësi të farës së grurit të eksportuar për periudhën '21-'23 ishte 0.45 €/kg, kurse vlera për njësi të miellit të eksportuar, mesatarisht ishte 0.36 €/kg.

Figura 14: Eksporti i grurit 2021-2023

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

¹⁶ Sasia përfshinë grurin, farën e grurit dhe nën produkte të grurit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të grurit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të grurit është konvertuar në grurë përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.


¹⁷ Në kalkulime të vlerës për njësi janë përfshirë kodet doganore CN10011100, CN10019110, CN10019120 dhe CN10019190 (këto kode janë edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

¹⁸ Në kalkulime të vlerës për njësi janë përfshirë kodet doganore CN11010011 dhe CN11010015 (këto kode janë edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

¹⁹ Në kalkulime të vlerës për njësi janë përfshirë kodet doganore CN10011900 dhe CN10019900. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

Në periudhën '21-'23, eksport të grurit kishte pothuajse gjatë gjithë vitit me përjashtim të muajve: qershor, korrik dhe gusht të vitit 2022 që nuk kishte farë grurë të eksportuar. Në periudhën '21-'23, vërehet se muaji tetor është koha kur realizohet sasia më e madhe e eksportit në krahasim me muajt tjerë të vitit. Vlera totale e eksportit të kulturës së grurit për periudhën '21-'23, ishte 5.3 mil €, që mesatarisht i bie eksport për muaj prej 147 mijë €.


Figura 15: Eksporti i grurit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Vendet kryesore ku është eksportuar gruri për vitet 2022 dhe 2023, janë Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Kurse vendet e tjera ku është eksportuar kultura e grurit janë përmbledhur në një kategori si “Të tjera”.

Figura 16: Eksporti i grurit sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i grurit

Kultura e grurit importohet në sasi të konsiderueshme ku mesatarja për periudhën '21-'23, ishte 135 mijë tonë. Kurse vlera monetare për periudhën '21-'23 e importeve të grurit ishte mesatarisht 39 mil. €.


Figura 17: Importi i grurit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Shikuar figurën e shpërndarjes së importit sipas muajve, vërehet se importohet grurë gjatë gjithë periudhës së vitit, importet më të mëdha ishin në muajin nëntor të vitit 2023, dhe mars 2022. Vërehet një rritje e importit në sasi gjatë dy viteve të fundit me një shpërndarje sipas muajve me luhatje por me një përqendrim kryesisht në periudhën korrik-tetor.


Figura 18: Importi i grurit sipas muajve në, '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Vendet nga të cilat Republika e Kosovës importoi grurë për vitin 2022 janë: Serbia me pjesëmarrje prej 70%, Hungaria me 10%, Austria dhe Kroacia me nga 5%, Franca me 4%, si dhe shtete tjera të grupuara si “Të tjera” me 6%. Për vitin 2023, shtetet nga ku është importuar gruri janë: Serbia me pjesëmarrje prej 59%, Ukraina 13%, Kroacia 8%, Austria 6%, Hungaria 5%, si dhe “Të tjera” me 9%.

Figura 19: Importi i grurit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.1.2 Eksporti dhe importi i misrit

Tabela e mëposhtme paraqet detajet sa i përket eksportit dhe importit të misrit për periudhën '21-'23, ku vërehet se sasia e eksportuar është shumë më e vogël në krahasim me sasinë e importuar.

Viti 2023, tregon bilancin tregtar për misrin që është negativ në vlerë prej 10.9 mil. €, dhe në sasi një deficit prej 41 mijë tonë.

Pavarësisht rënies të sasisë të eksportit vlera totale e eksportit është ngritur, si rezultat i ngritjes së çmimit për njësi. Përveç ngritjes së çmimit për kg të misrit të eksportuar, ngritje të çmimeve kishte edhe fara e misrit.

Importet e farës së misrit dhe miellit të misrit kishin ngritje të vlerës për njësi, me përjashtim të misrit që kishte rënie në vitin 2023 për 0.09 €/kg.


Tabela 8: Eksporti dhe importi i misrit

		2021	2022	2023
Eksporti	Vlera në €	187,563	186,872	193,692
	Sasia në kg ²⁰	201,780	100,320	90,028
	Vlera për njësi të farës së misrit të eksportuar (€/kg) ²¹	2.12	2.67	3.81
	Vlera për njësi të misrit të eksportuar (€/kg) ²²	0.19	0.41	0.45
	Vlera për njësi të miellit të eksportuar (€/kg) ²³	0.78	1.16	1.15
Importi	Vlera në €	12,233,467	14,279,306	11,060,932
	Sasia në kg	47,326,770	41,774,261	41,111,505
	Vlera për njësi të farës së misrit të importuar (€/kg)	2.47	3.37	4.34
	Vlera për njësi të misrit të importuar (€/kg)	0.22	0.29	0.20
	Vlera për njësi të miellit të eksportuar (€/kg)	0.61	0.69	0.99

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i misrit

Viti 2021, ishte viti me sasinë më të lartë të eksporteve të kulturës së misrit, ku u eksportuan 202 tonë me vlerë 188 mijë €. Kurse viti 2023, ishte viti me sasinë më të ulët të eksportit me 90 tonë. Për shkak të çmimit më të lartë, ky eksport arrin vlerë më të lartë gjatë vitit 2023, me 194 mijë €. Vlera për njësi e eksportit të misrit dhe farës së misrit të eksportuar, vazhdimisht kishte ngritje me përjashtim të miellit që në vitin 2023 kishte vlerë për njësi më të ulët për 0.01 €/kg në krahasim me vitin 2022.

Figura 20: Eksporti i misrit 2021-2023

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

²⁰ Sasia përfshinë misrin, farën e misrit dhe nën produkte të misrit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të misrit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të misrit është konvertuar në misër përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.


²¹ Në kalkulime të vlerës për njësi janë përfshirë kodet doganore CN10051013, CN10051015, CN10051018 dhe CN10051090 (këto kode janë edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

²² Në kalkulime të vlerës për njësi është i përfshirë kodi doganore CN10059000 (ky kod është edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

²³ Në kalkulime të vlerës për njësi janë përfshirë kodet doganore CN11022010 dhe CN11022090 (këto kode janë edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

Shikuar në aspektin kohor, kultura e misrit eksportet më të mëdha i kishte gjatë muajve mars dhe tetor në vitet '21-'22, kurse gjatë vitit 2023, muaji dhjetor ishte muaji kur u realizuan eksportet më të mëdha.


Figura 21: Eksporti i misrit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Kultura e misrit për vitin 2023, më së shumti është eksportuar në Serbi me 48%, Gjermani me 33%, Kroaci dhe Francë me nga 4%, kurse vendet e tjera të grupuara si “Të tjera” kanë një pjesëmarrje prej 11%. Ndërsa në vitin 2022, shtetet ku ishte eksportuar kultura e misrit janë Shqipëria me 37%, Gjermania me 29%, Kroacia me 28%, si dhe vendet e tjera me 6%.

Figura 22: Eksporti i misrit sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i misrit

Kultura e misrit gjatë viteve '21-'23, është importuar mesatarisht 43 mijë tonë për vit, me vlerë mesatare 12.5 mil. € për vit. Vlera më e lartë për njësi të farës së misrit të importuar ishte 4.34 €/kg në vitin 2023, kurse vlera më e ulët për njësi e misrit ishte gjatë vitit 2023 me 0.20 €/kg.


Figura 23: Importi i misrit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në ndarjen në mes të muajve, importi i kulturës së misrit nuk dallon nga viti në vit, përjashtuar muajt mars gjatë periudhës '21-'23, ku vërehet një nivel më i lartë i importeve. Marrë në përgjithësi niveli i importit në të gjitha vitet është më i ulët në kohën e korrjes së prodhimit vendor.

Figura 24: Importi i misrit sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Gjatë periudhës '22-'23, importet nuk kishin një ndryshim shumë të theksuar në mes shteteve mbizotëruese të importit, ku shteti i Serbisë kishte një përqindje më të theksuar të pjesëmarrjes prej 86% në vitin 2022, pasuar nga Bullgaria dhe Turqia me nga 3%, Franca dhe Kroacia me nga 2%, si dhe shtetet të tjera me 4%.

Ndërsa në vitin 2023, importet e misrit u realizuan nga Serbia me pjesëmarrje 71%, Kroacia me 9%, Turqia me 5%, Ukraina dhe Maqedonia e Veriut me nga 3%, si dhe shtetet të tjera me 9%.

Figura 25: Importi i misrit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.1.3 Eksporti dhe importi i elbit

Kultura e elbit eksportohet në sasi shumë të vogël, ku në total për periudhën '21-'23 janë eksportuar rreth 85 tonë, me vlerë rreth 37 mijë €. Për plotësimin e nevojave të përdorimit vendor²⁴ kultura e elbit importohet edhe nga vendet tjera.

Në vitet '21-'23, sasia e importuar e elbit kishte luhatje (ulje - ngritje) nëse e krahasojmë nga viti në vit, mirëpo luhatje kishte edhe në vlera. Vlera mesatare e elbit të freskët të importuar për vitet '21-'23 ishte 0.22 €/kg, përveç kulturës së elbit që është tregtuar, kemi edhe sasi të farës së elbit të tregtuar.

²⁴ Përdorimi vendor përfshinë sasinë e përdorur për konsum nga njerëzit, sasinë e përdorur për konsum nga kafshët si dhe përdorimin në industrinë përpunuese.


Tabela 9: Eksporti dhe importi i elbit

		2021	2022	2023
Eksporti	Vlera në €	24,720	-	12,250
	Sasia në kg ²⁵	60,000	-	25,000
	Vlera për njësi të farës së elbit të eksportuar (€/kg) ²⁶	0.41	-	0.49
Importi	Vlera në €	2,432,415	1,698,038	3,337,893
	Sasia në kg	7,860,694	4,764,119	6,310,167
	Vlera për njësi të farës së elbit të importuar (€/kg)	0.36	0.55	0.43
	Vlera për njësi të elbit të importuar (€/kg) ²⁷	0.23	0.27	0.17

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i elbit

Sasia e eksportuar e kulturës së elbit gjatë periudhës '21-'23 ishte shumë e vogël, ku gjatë vitit 2022, s'kishte fare eksport. Gjatë viteve të tjera eksportet ishin modeste në krahasim me importet, dhe kishte vetëm farë elbi të eksportuar me vlerë për njësi prej 0.49 €/kg në vitin 2023, që ishte vlerë dukshëm më e lartë në raport me vitin 2021 (0.41 €/kg), kurse si sasi totale ishte më e ulët më vitin 2023

Figura 26: Eksporti i elbit 2021-2023

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


Kultura e elbit ishte eksportuar në muajt tetor dhe nëntor për vitin 2021, kurse gjatë vitit 2023, ishte eksportuar e gjithë sasia gjatë muajit nëntor.

²⁵ Sasia përfshinë elbin, farën e elbit dhe nën produkte të elbit të fazës së parë të përpunimit si miell dhe produkte të tjera të elbit. (Sasia e miellit dhe nënprodukteve të elbit është konvertuar në elb përmes koeficientëve të konvertimit). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

²⁶ Në kalkulime të vlerës për njësi është i përfshirë kodi doganore CN10031000 (ky kod është edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

²⁷ Në kalkulime të vlerës për njësi është i përfshirë kodi doganore CN10039000. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

Figura 27: Eksporti i elbit sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Shikuar shpërndarjen sipas shteteve ku është eksportuar kultura e elbit gjatë periudhës '22-'23, vërehet se i gjithë eksporti ishte në drejtim të shtetit të Shqipërisë.

Importi i elbit

Për të plotësuar nevojat e konsumit vendor importi i kulturës së elbit për periudhë '21-'23 ishte 18,935 tonë, me vlerë 7.47 mil. €. Vlera për njësi e elbit të importuar në vitin 2023 ishte 0.17 €/kg, për 0.10 €/kg apo 38% më e ulët se në vitin paraprak.


Figura 28: Importi i elbit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Prodhimi vendor i kulturës së elbit nuk i plotëson nevojat e përdorimit vendor. Elbi importohet pothuajse në çdo muaj të vitit me një rënie modeste në muajin e korres së prodhimit vendor.


Figura 29: Importi i elbit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Ndarë sipas shteteve, importi i kulturës së elbit për vitin 2022, ishte i mbizotëruar nga shteti i Kroacisë me 85%, pasuar nga Serbia me 10%, Gjermania me 3% pjesëmarrje, si dhe shtetet e tjera me 2%. Kurse viti 2023, ishte prapë i mbizotëruar me importe nga Kroacia me pjesëmarrje prej 94%, pasuar nga Serbia me 3%, Gjermania me 2%, kurse pjesëmarrja e shteteve të tjera ishte vetëm 1%.

Figura 30: Importi i elbit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.1.4 Eksporti dhe importi i tërshërës

Tabela e mëposhtme paraqet eksportin dhe importin e tërshërës për periudhën '21-'23. Në krahasim me importin vlerat e eksportit të tërshërës janë shumë më të ulëta.

Tabela 10: Eksporti dhe importi i tërshërës


		2021	2022	2023
Eksporti	Vlera në €	0	242	0
	Sasia në kg ²⁸	0	149	0
	Vlera për njësi të tërshërës së eksportuar (€/kg) ²⁹	-	1.63	-
Importi	Vlera në €	15,576	32,247	32,762
	Sasia në kg	68,881	102,779	84,930
	Vlera për njësi të farës së tërshërës së importuar (€/kg) ³⁰	0.41	0.38	0.66
	Vlera për njësi të tërshërës së importuar (€/kg)	0.22	0.31	0.37

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i tërshërës

Figura e mëposhtme paraqet eksportet e kulturës së tërshërës gjatë periudhës '21-'23, ku eksporte kishte vetëm gjatë vitit 2022, e që janë me vlerë prej 242 € dhe sasi 149 kg, kjo sasi u eksportua me çmim prej 1.63 €/kg.

Figura 31: Eksporti i tërshërës 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


²⁸ Sasia përfshinë tërshërën dhe farën e tërshërës. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

²⁹ Në kalkulime të vlerës për njësi është i përfshirë kodi doganore CN10049000 (ky kod është edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

³⁰ Në kalkulime të vlerës për njësi është i përfshirë kodi doganore CN10041000. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

Eksporti modest i kulturës së tërshërës i realizuar gjatë viti 2022, është realizuar i tëri gjatë muajit nëntor.

Figura 32: Eksporti i tërshërës sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Shikuar shpërndarjen sipas shteteve ku është eksportuar kultura e tërshërës gjatë periudhës '21-'23, vërehet se i gjithë eksporti ishte në drejtim të shtetit të Shqipërisë.

Importi i tërshërës


Kultura e tërshërës gjatë viteve '21-'23, është importuar mesatarisht 85.5 tonë për vit, me vlera mesatare prej 27 mijë. €. Vlera më e lartë për njësi të tërshërës të importuar ishte 0.37 €/kg në vitin 2023, më e ulëta ishte në vitin 2021 me 0.22 €/kg, ndërsa vlera për njësi e farës së tërshërës të importuar shënoi nivelin më të lartë në vitin 2023, me 0.66 €/kg, kurse vlerën më të ulët e kishte në vitin 2022 me 0.38 €/kg.

Figura 33: Importi i tërshërës 2021-2023



Në ndarjen në mes të muajve importi i kulturës së tërshërës duket i ngjashëm nga viti në vit. Marrë në përgjithësi, niveli i importit në të gjitha vitet është më i ulët në kohën e korres së prodhimit vendor, në muajt qershor dhe korrik. Kurse piku i importit gjatë periudhës '21-'23, ishte gjatë muajve janar, shkurt dhe mars.


Figura 34: Importi i tërshërës sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Gjatë periudhës '22-'23, importet e tërshërës nuk kishin një ndryshim të theksuar në mes shteteve, ku në vitin 2022, Hungaria kishte një përqindje më të theksuar të pjesëmarrjes prej 52%, pasuar nga Kroacia me 39%, Serbia me 5%, si dhe shtetet tjera të grupuara në një kategori si "Të tjera" me 4%. Ndërsa në vitin 2023, importet e tërshërës u realizuan nga shteti i Hungarisë me pjesëmarrje prej 60%, Kroacia me 38%, si dhe shtetet e tjera me 2% të pjesëmarrjes.

Figura 35: Importi i tërshërës sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.1.5 Eksporti dhe importi i thekrës

Bilanci tregtar i kulturës së thekrës në vlera dhe sasi mbetet negativ. Në tabelën e mëposhtme vërehen dallime të mëdha në mes të eksportit dhe importit, me një rritje modeste të eksportit. Eksportet e kulturës së thekrës në periudhën '21-'23, si përqindje mesatare e pjesëmarrjes në eksportet e përgjithshme të drithërave janë shumë të vogla, mirëpo duket se kultura e thekrës ka një vlerë jashtëzakonisht të mirë për njësi prej 0.99 €/kg.

Tabela 11: Eksporti dhe importi i thekrës


		2021	2022	2023
Eksporti	Vlera në €	743	693	1,040
	Sasia në kg ³¹	750	700	1,050
	Vlera për njësi të thekrës së eksportuar (€/kg) ³²	0.99	0.99	0.99
Importi	Vlera në €	21,229	9,325	41,947
	Sasia në kg	99,494	25,000	176,130
	Vlera për njësi të thekrës së importuar (€/kg)	0.21	0.37	0.24

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i thekrës

Figura e mëposhtme shfaq eksportin e thekrës në vlera dhe sasi, ku gjatë gjithë periudhës '21-'23 është eksportuar në total rreth 2.5 tonë. Vlera totale e eksporteve ishte 2.5 mijë €. Në vitin 2023, ka pasuar një sasi më të madhe të eksporteve, me vlerë të njëjtë prej 0.99 €/kg, vlerë e cila ishte e njëjtë përgjatë gjithë periudhës '21-'23.

Figura 36: Eksporti i thekrës 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

³¹ Sasia përfshinë thekrën dhe farën e thekrës. Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

³² Në kalkulime të vlerës për njësi është i përfshirë kodi doganore CN10029000 (ky kod është edhe tek importi). Lista e kodeve doganore të përfshira është e paraqitur në Shtojca 1.

Eksportet e kulturës së thekrës e paraqitur në figurën sipas muajve duket se kanë një shpërndarje të ndryshme, ku muaji janar dhe gusht mbizotëruan në vitin 2023, qershori, korriku dhe dhjetori përgjatë vitit 2021, kurse eksporti i kulturës së thekrës gjatë vitit 2022 ishte i gjithi në muajin mars.

Figura 37: Eksporti i thekrës sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Shikuar shpërndarjen sipas shteteve ku është eksportuar kultura e thekrës gjatë periudhës '21-'23, vërehet se i gjithë eksporti në vitet 2022 dhe 2023, ishte në drejtim të shtetit të Malit të Zi, kurse në vitin 2021 përveç Malit të Zi eksporte kishte edhe në Kroaci.

Importi i thekrës

Gjatë periudhës '21-'23, mesatarja e sasisë së importit të kulturës së thekrës ishte 100 tonë. Vlera mesatare për njësi e thekrës të importuar ishte 0.27 €/kg, ku vërehet se kishte luhatje (ulje dhe ngritje) të vlerës nga viti në vit.


Figura 38: Importi i thekrës 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i thekrës i ndarë sipas muajve vërehet shumë i shpërndarë në vite, ku për vitin 2021, ishte në muajt janar dhe nëntor, gjatë vitit 2022, i gjithë importi i thekrës ishte i përqendruar në muajin dhjetor, kurse gjatë vitit 2023, ishte në muajt shkurt, gusht dhe dhjetor.

Figura 39: Importi i thekrës sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i thekrës ndarë sipas shteteve për periudhën '21-'23, ishte pothuajse i gjithë nga shteti i Hungarisë, me përjashtim të vitit 2021 ku importe kishte edhe nga Serbia, me një pjesëmarrje prej 36%.

3 Çmimet e drithërave

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur çmimet për 5 kulturat kryesore në grupin e drithërave më të kultivuara në Kosovë, ku çmimet janë të paraqitura në nivel ferme. Në vitin 2023, të gjitha kulturat kanë shënuar rënie të çmimit përveç elbit i cili rezultoi me rritje të çmimit.

Tabela 12: Çmimet e drithërave 2021-2023


Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg				
	2021	2022	2023	Ndryshimi 2022/2023 (%)
Grurë	0.20	0.29	0.20	-31
Misër	0.28	0.32	0.19	-41
Elb	0.35	0.37	0.40	8
Thekër	0.58	0.64	0.27	-58
Tërshërë	0.35	0.47	0.29	-38

Burimi: DAESB-MBPZhR

3.1 Çmimi për grurë

Çmimi mesatar për grurë në vitet '21-'23 ishte 0.23 €/kg, çmimi më i lartë ishte në vitin 2022 me 0.29 €/kg, ndërsa për vitet 2021 dhe 2023, nuk ka pasur ndryshim të çmimeve dhe ishte 0.20 €/kg.

Figura 40: Çmimi për grurë, 2021-2023




Burimi: DAESB-MBPZhR

3.2 Çmimi për misër

Çmimi mesatar i fermës për misër në periudhën '21-'23 ishte 0.26 €/kg, çmimet kanë pasur ndryshime gjatë viteve, çmimi më i ulët ishte për vitin 2023 me 0.19 €/kg, dhe ai më i larti ishte në vitin 2022 me 0.32 €/kg.

Figura 41: Çmimi për misër, 2021-2023




Burimi: DAESB-MBPZhR

3.3 Çmimi për elb

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e elbit për periudhën '21-'23 ishte 0.37 €/kg, tek elbi kemi rritje të vazhdueshme të çmimeve gjatë viteve, ku rritje më të lartë ka shënuar viti 2023, që çmimi ishte 0.40 €/kg, gjatë vitit 2022 ishte 0.37 €/kg, dhe 2021 me 0.35 €/kg.

Figura 42: Çmimi për elb, 2021-2023




Burimi: DAESB-MBPZhR

3.4 Çmimi për thekër

Çmimi i fermës për thekër në vitin 2023 ishte 0.27 €/kg, ku kishte rënie të çmimit krahasuar me dy vitet paraprake, ku në vitin 2022 çmimi ishte 0.64 €/kg, kurse çmimi 0.58 €/kg ishte në vitin 2021.

Figura 43: Çmimi për thekër, 2021-2023




Burimi: DAESB-MBPZhR

3.5 Çmimi për tërshërë

Çmimi i fermës për kulturën e tërshërës ka pësuar ndryshime në vite, më i larti ishte në vitin 2022 me 0.47 €/kg, pasuar në vitin 2023 me rënie në 0.29 €/kg, kurse viti 2021 kishte çmimin prej 0.35 €/kg.

Figura 44: Çmimi për tërshërë, 2021-2023



Burimi: DAESB-MBPZhR

4 Mbështetja direkte për sektorin e drithërave

Sektori i drithërave mbështetet përmes Programit të Pagesave Direkte.

Tabela 13: Pagesat direkte për sektorin e drithërave 2021-2023

		2021	2022	2023
Grurë (ha)	Numri i aplikuesve	6,862	11,331	17,250
	Numri i përfituesve	6,553	11,130	16,525
	Numri i ha të paguar	27,860	49,893	64,395
	Pagesa për ha	75	354	204
	Shuma totale e paguar	2,089,499	17,661,357	13,136,627
Grurë (kg)	Numri i aplikuesve	3,801	3,555	8,466
	Numri i përfituesve	3,550	3,555	8,043
	Numri i kg të paguar	63,028,896	64,179,802	101,645,333
	Pagesa për kg	0.019	0.03	0.03
	Shuma totale e paguar	1,197,549	1,925,395	3,049,360
Farë gruri	Numri i aplikuesve	16	3	6
	Numri i përfituesve	14	3	6
	Numri i ha të paguar	528	161	334
	Pagesa për ha	250	304	304
	Shuma totale e paguar	131,913	48,895	101,454
Farë gruri (kg)	Numri i aplikuesve	-	-	6
	Numri i përfituesve	-	-	6
	Numri i kg të paguar	-	-	1,009,050
	Pagesa për kg	-	-	0.04
	Shuma totale e paguar	-	-	40,362
Misër	Numri i aplikuesve	7,510	11,331	13,312
	Numri i përfituesve	7,224	11,651	12,482
	Numri i ha të paguar	18,934	35,876	39,467
	Pagesa për ha	150	329	229
	Shuma totale e paguar	2,840,082	11,803,368	9,037,918
Elb	Numri i aplikuesve	856	455	400
	Numri i përfituesve	820	437	387
	Numri i ha të paguar	2,054	753	647
	Pagesa për ha	150	204	204
	Shuma totale e paguar	308,040	153,708	131,919
Thekër	Numri i aplikuesve	182	131	101
	Numri i përfituesve	173	124	99
	Numri i ha të paguar	532	413	236
	Pagesa për ha	150	204	204
	Shuma totale e paguar	79,845	84,152	48,073
Tërshërë	Numri i aplikuesve	746	876	786
	Numri i përfituesve	706	829	725
	Numri i ha të paguar	1,665	1,695	1,610
	Pagesa për ha	150	204	204
	Shuma totale e paguar	249,689	345,727	328,497

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR


Pagesa për hektar është e ndryshme varësisht prej kulturës, më e larta është për farë gruri me 304 €/ha, pasuar nga misri me 229 €/ha, ndërsa kulturat tjera si: gruri, elbi, thekra, tërshëra janë të ngjashme dhe mbështeten për sipërfaqe me 204 €/ha.

Në rastin e grurit për kg, pagesa në vitin 2023 ishte 0.03 €, që ishte e njëjtë me vitin 2022, ndërsa në vitin 2021, ishte më e ulët përkatësisht me 0.019 €/kg. Mbështetje për rendiment (kg), jepet edhe për farë gruri përkatësisht 0.04 €/kg apo 0.01 €/kg më shumë sesa për grurin. Numri më i madh i përfituesve ishte në vitin 2023, për kulturën e grurit përkatësisht 16,525 përfitues (prej të cilëve për sasi (kg) ishin 8,043), pasuar nga misri me 12,482, tërshëra 725, elbi 387, thekra 99 dhe për farë gruri 6 përfitues të cilët njëkohësisht përfituan mbështetje edhe për sasi të farës së grurit.

Gjatë periudhës '21-'23, pjesëmarrja mesatare e pagesave direkte për sektorin e drithërave, (përfshirë pagesat për sipërfaqe, prodhim dhe naftë) ishte 40.2%.

Gjatë kësaj periudhe kohore, pjesëmarrja më e lartë ishte në vitin 2022 me 55.7%. Gjithsej pagesat për sektorin e drithërave në vitin 2023, ishin 25.9 mil. €, më e ulët për 19.2% në raport me pagesat në vitin 2022, ndërsa në krahasim me vitin 2021, pagesat direkte për drithëra janë rritur për më shumë se 4 herë.

Figura 45: Pjesëmarrja e pagesave direkte për drithëra³³ në gjithsej shumën e pagesave direkte




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2023, shuma e pagesave direkte për drithëra më e larta ishte për grurë me pjesëmarrje prej 62.6%, misër 34.9%, me 1.3% pjesëmarrje tërshëra, elbi me 0.5%, fara e grurit me 0.4% dhe thekra dhe mbështetja për farë gruri për kg kishin 0.2% pjesëmarrje.

³³ Gjatë kalkulimit të pjesëmarrjes si total për sektorin e drithërave është përdorur (shuma për grurë (ha dhe kg), farë gruri (ha dhe kg), misër, elb, thekër, dhe tërshërë).

Figura 46: Shpërndarja e pagesave direkte sipas kulturave (%)



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.1 Pagesa direkte për grurë

Në vitin 2023, numri i aplikuesve për mbështetje direkte për grurë ishte 17,250 fermer, përfituan 16,525 fermer, dhe u refuzuan 725 për mos përmbushje kriteresh apo mungesë të dokumentacionit. Numri i hektarëve të subvencionuar ishte 64,395 ha, dhe gjithsej shuma e mbështetjes ishte mbi 13 mil. €. Pagesa për njësi në vitin 2023 ishte 204 €/ha.

Në vitin 2022, përmes Programit të Pagesave Direkte, çdo aplikues i cili përfitoi subvencion për sipërfaqe të tokës së kultivuar me kultura të drithërave u subvencionua edhe për naftë me nga 0.36 €/litër për sasinë maksimale prej 150 litrave për hektar, gruri me misër u mbështeten për pleh, me 150 €/ha gruri, si dhe me 100 €/ha u mbështet misri. Kurse gruri u mbështet edhe për rendiment me 0.03 €/kg.

Në vitin 2023, totali i mbështetjes përmes pagesave direkte ishte 63.1 mil. €, ku pjesëmarrje më të madhe në gjithsej pagesat direkte për kultura bujqësore kishin drithërat me 41% apo 25.9 mil. €.

Në shumatat totale të pagesave, plehu merr pjesë me 11.1 mil. €, apo me 17.6%, ku mbështetja është bërë bazuar në faturat e blerjes së plehut të dorëzuar, për dallim nga viti 2022, ku pagesat për pleh ishin të përfshira dhe të prezantuara në kuadër të pagesës bazë për hektar.


Tabela 14: Pagesa direkte për grurë, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	6,862	11,331	17,250
Numri i përfituesve	6,553	11,130	16,525
Numri i ha të paguar	27,860	49,893	64,395
Pagesa për ha	75	354	204
Shuma totale e paguar	2,089,499	17,661,357	13,136,627

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2023, numri i aplikuesve për grurë ishte më i lartë në krahasim me vitet paraprake.

Figura 47: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për grurë



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2 Pagesat direkte për grurë kg

Në vitin 2023, numri i aplikuesve për mbështetje direkte për sasi të grurit ishte 8,466 fermer, nga të cilët 95% përfituan, ndërsa për mos përmbushje kriteresh apo mungesë të dokumentacionit u refuzuan 5%.

Numri i kilogramëve të subvencionuar ishte 101 mijë tonë, kurse pagesa për kilogram ishte 0.03 €/kg. Shuma totale e paguar për vitin 2023, ishte mbi 3 mil. €.


Tabela 15: Pagesa direkte për grurë kg, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	3,801	3,555	8,466
Numri i përfituesve	3,550	3,555	8,043
Numri i kg të paguar	63,028,896	64,179,802	101,645,333
Pagesa për kg	0.019	0.03	0.03
Shuma totale e paguar	1,197,549	1,925,395	3,049,360

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i përfituesve në vitin 2023, ka qenë më i madh në krahasim me vitet paraprake, sasia e grurit për kg të subvencionuar në vitin 2023, ishte më e madhe se në vitin 2022 për 58.4%, kurse në krahasim me vitin 2021 për 61.3%. Shuma totale e pagesave për sasi të grurit për vitin 2023, ishte mbi 3 mil. €.

Figura 48: Sasia e subvencionuar dhe shuma e paguar për grurë kg



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.3 Pagesa direkte për farë gruri

Për farë gruri në vitet '22-'23, është një numër më i vogël i aplikuesve në krahasim me vitin 2021, që ishin 16 aplikues, ku 2 prej tyre janë refuzuar dhe 14 prej tyre kanë përfituar, për vitin 2022 ishin 3 aplikues, 3 përfitues, dhe për vitin 2023, janë 6 aplikues dhe po aq përfitues.

Numri i ha të paguar për vitin 2023 ishte 334 ha, pagesa ishte 304 €/ha. Gjithsej shuma totale e paguar ishte mbi 101 mijë €.


Tabela 16: Pagesa direkte për farë gruri, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	16	3	6
Numri i përfituesve	14	3	6
Numri i ha të paguar	528	161	334
Pagesa për ha	250	304	304
Shuma totale e paguar	131,913	48,895	101,454

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sipërfaqja për farë gruri e subvencionuar në vitin 2023, ishte 54 €/ha më e lartë sesa në vitin 2021 sepse u përfshi edhe subvencionimi i naftës, ndërsa në krahasim me pagesat për vitin 2022 ishin të njëjta. Në vitin 2023, një përfitues mesatarisht u mbështet për 55.7 ha, ndërsa shuma mesatare e përfituar nga një përfitues ishte 17 mijë €.

Figura 49: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për farë gruri



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.4 Pagesa direkte për farë gruri për kg

Në vitin 2023, për herë të parë filloi mbështetja e fermerëve për rendimentin e farës së grurit, ku numri i aplikuesve për mbështetje direkte për sasi të farës grurit ishte 6, nga të cilët të gjithë përfituan.

Sasia e subvencionuar ishte 1,010 tonë, kurse pagesa për kilogram ishte 0.04 €/kg. Shuma totale e paguar për vitin 2023, ishte mbi 40 mijë. €.

Tabela 17: Pagesa direkte për farë gruri për kg, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	-	-	6
Numri i përfituesve	-	-	6
Numri i kg të paguar	-	-	1,009,050
Pagesa për kg	-	-	0.04
Shuma totale e paguar	-	-	40,362

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.5 Pagesa direkte për misër


Për kulturën e misrit në vitin 2023, kemi rritje të madhe të aplikuesve, ishin 13,312 aplikues, krahasuar me vitin 2021 rritja shënon 77.3%. Rritja vjen si rezultat i rritjes së pagesës për hektar, ishte 150 €/ha për vitin 2021, u rrit në 229 €/ha në vitin 2023. Shuma totale e pagesave direkte për misër në vitin 2023, ishte mbi 9 mil. €. Në vitin 2022 në kuadër të pagesës për ha ishte e përfshirë edhe pagesa për pleh, ndërsa në vitin 2023, ajo është realizuar si pagesë shtesë përveç pagesës për ha.

Tabela 18: Pagesa direkte për misër, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	7,510	11,331	13,312
Numri i përfituesve	7,224	11,651	12,482
Numri i ha të paguar	18,934	35,876	39,467
Pagesa për ha	150	329	229
Shuma totale e paguar	2,840,082	11,803,368	9,037,918

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sipërfaqja e misrit të subvencionuar në vitin 2023, ishte për 10% më e madhe sesa në vitin 2022, dhe 108% më e madhe në raport me vitin 2021. Shuma totale e paguar për vitin 2023, ishte 9 mil. €, vlerë më e vogël krahasuar me vitin 2022 (por nëse vitit 2023 i shtohet edhe pagesa prej 100 €/ha për pleh që është realizuar si e ndarë, atëherë edhe në vitin 2023 është shënuar rritje), dhe më e madhe krahasuar me vitin 2021.

Figura 50: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për misër

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.6 Pagesa direkte për elb

Tek elbi në vitin 2023, numri i aplikuesve për mbështetje direkte kishte rënie për 12.1%, në krahasim me vitin 2022. Në vitin 2022 pagesa kishte ngritje prej 54 €/ha apo në përqindje prej 36%, pagesa për ha për periudhën '22-23' nuk ndryshoi dhe ishte 204 €/ha. Gjithsej shuma totale e paguar për elb në vitin 2023, ishte 132 mijë €.


Tabela 19: Pagesa direkte për elb, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	856	455	400
Numri i përfituesve	820	437	387
Numri i ha të paguar	2,054	753	647
Pagesa për ha	150	204	204
Shuma totale e paguar	308,040	153,708	131,919

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sipërfaqja për elb e subvencionuar më e larta ishte për vitin 2021 më 2,054 ha, për vitet '22-'23 ka pasur një rënie të madhe, ku sipërfaqja për vitin 2022 ishte 753 ha, dhe për vitin 2023 ishte 647 ha. Shuma e paguar gjithsej për periudhën '21-'23 ishte 594 mijë €. Edhe për elbin përveç pagesës bazë për hektar, është realizuar edhe pagesa prej maksimum 100 €/ha në bazë të faturave të plehut të blerë dhe të përdorur.

Figura 51: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për elb



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.7 Pagesa direkte për thekër

Për kulturën e thekrës, kemi rënie të aplikuesve përgjatë viteve ku mesatarja e aplikuesve për periudhën '21-'23 ishte 138, numri i përfituesve mesatarisht ishte 132. Numri i hektarëve të subvencionuar për vitin 2023 ishte 236, dhe gjithsej shuma e mbështetjes ishte 48 mijë €. Në vitin 2022 pagesa kishte ngritje prej 54 €/ha apo në përqindje prej 36%, pagesa në periudhën '22 -'23 nuk ndryshoi dhe ishte 204 €/ha.

Tabela 20: Pagesa direkte për thekër, 2021-2023


	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	182	131	101
Numri i përfituesve	173	124	99
Numri i ha të paguar	532	413	236
Pagesa për ha	150	204	204
Shuma totale e paguar	79,845	84,152	48,073

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri mesatar i hektarëve të thekrës së subvencionuar në periudhën '21-'23 ishte 394 ha, kurse numri më i lartë i hektarëve të mbështetur ishte në vitin 2021 me 532 ha. Në vitin 2023, një përfitues mesatarisht u mbështet për 2.4 ha, ndërsa shuma mesatare e përfituar nga një

përfitues ishte 486 €. Pagesa shtesë për thekër në maksimum 100 €/ha në bazë të faturave të plehut të blerë dhe të përdorur është realizuar si edhe për kulturat e tjera.

Figura 52: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për thekër



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.8 Pagesa direkte për tërshërë

Në vitin 2023, numri i aplikuesve për mbështetje direkte për tërshërë ishte 786 fermerë, nga të cilët 725 përfituan dhe 61 aplikues për mos përmbushje kriteresh apo mungesë të dokumentacionit janë refuzuar. Numri i hektarëve të subvencionuar ishte 1,610 ha, dhe gjithsej shuma e mbështetjes ishte 328 mijë €. Pagesa për njësi në periudhën '22-23', nuk ndryshoi dhe ishte 204 €/ha.


Tabela 21: Pagesa direkte për tërshërë, 2021-2023

	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	746	876	786
Numri i përfituesve	706	829	725
Numri i ha të paguar	1,665	1,695	1,610
Pagesa për ha	150	204	204
Shuma totale e paguar	249,689	345,727	328,497

Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Për tërshërën, sipërfaqja e subvencionuar nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh, ku mesatarja për vitet '21-23' ishte 1,657 ha, kurse shuma totale e paguar ishte më e larta në vitin 2022, me 346 mijë € kur edhe sipërfaqja e subvencionuar ishte më e larta. Përveç pagesës prej 204 €/ha, përftuesit morrën edhe nga 100 € maksimum, për çdo hektar të subvencionuar por që kjo ishte në varësi të faturave të dorëzuara për plehun e blerë dhe të përdorur.

Figura 53: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për tërshërë



Burimi: Të dhënat nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

5 Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi


Republika e Kosovës është prodhuese por edhe tregtuese e produkteve bujqësore, veçmas drithërave, ku prodhimi është dukshëm më i madh sesa importi, por përkundër kësaj kemi edhe eksporte modeste të kulturave në grupin e drithërave. Nevoja për të importuar drithëra nga vendet e tjera vjen nga ajo se Kosova nuk arrin të plotësoj nevojat e tërësishme konsumuese të popullsisë me prodhim vendor por edhe nevojat për përdorimin e drithërave si ushqim për kafshë.

5.1 Plotësimi i nevojave vendore me drithëra

Prodhimi vendor i drithërave plotëson nevojat për përdorim brenda vendit në nivelin mesatar prej 74%, përgjatë periudhës '21-'23, marr në konsideratë jo vetëm konsumin njerëzor por edhe përdorimin si ushqim për kafshë, andaj pjesa tjetër plotësohet nga prodhimet e importit.

Në vitin 2023, prodhimi vendor i drithërave ishte 477,149 tonë, ndërsa u importuan 207,042 tonë, eksporti ishte 5,522 tonë, ku rezulton me përqindje të plotësimit të nevojave vendore prej 70%, 6 pikë të përqindjes më pak se në vitin 2022, si dhe 5 pikë të përqindjes më pak se viti 2021. Konsumi i drithërave për vitin 2023, ishte 214 kg për kokë banori.

Figura 54: Furnizimi me drithëra, 2021-2023




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

5.1.1 Plotësimi i nevojave vendore për drithëra më të kultivuara

Përgjatë vitit 2023, u prodhuan 303,496 tonë me grurë, u importuan 160,994 tonë, ndërsa eksporti ishte tejet simbolik me vetëm 7,162 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për përdorim të grurit me prodhim vendor ishte 66%, apo 7 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2022, dhe 8 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2021.

Ndërsa, konsumi mesatar për kokë banori gjatë periudhës '21-'23 ishte 179 kg, kurse niveli më i lartë i konsumit të grurit ishte në vitin 2023, me 196 kg për kokë banori.


Figura 55: Furnizimi me grurë, 2021-2023



Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Gjatë vitit 2023, u prodhuan 161,667 tonë me misër, u importuan 41,112 tonë, ndërsa eksporti ishte tejet i ulët me vetëm 90 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për misër me prodhim vendor ishte 80%, apo 1 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2022, dhe 2 pikë përqindje më e lartë sesa në vitin 2021. Ndërsa, konsumi mesatar për kokë banori gjatë periudhës '21-'23, ishte 13 kg për vit.

Figura 56: Furnizimi me misër, 2021-2023




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2023, u prodhuan 4,554 tonë me tërëshërë, u importuan 309 tonë, ndërsa eksporti kishte shumë pak, me përjashtim të vitit 2022, që kishte një sasi eksporti pak më të lartë prej 8 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për tërëshërë me prodhim vendor ishte 94%, ku si përqindje e plotësimit të nevojave ishte e afërsisht e njëjtë

gjatë gjithë periudhës '21-'23. Pjesa prej 6% mbulohet nga importi, kurse konsumi për kokë banori ishte mesatarisht më pak se 0.5 kg për vit.


Figura 57: Furnizimi me tërshërë, 2021-2023



Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Kultura e elbit është kulturë e cila nuk i plotëson tërësisht nevojat për përdorim vendor përfshirë konsumin e popullsisë në Kosovë, por edhe pjesën që është e nevojshme dhe përdoret si udhqim për kafshë, andaj edhe importohet një sasi e elbit duke rezultuar me bilanc tregtar negativ. Gjatë periudhës '21-'23, janë prodhuar mesatarisht 5,660 tonë, shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore me elb në vitin 2021, ishte 41%, shkallë e cila ishte me ulëta e kësaj periudhe, ajo më e larta ishte 54% në vitin 2022, kurse viti 2023, ishte me një shkallë të vetëmjaftueshmërisë prej 46%. Përqindje që jep të kuptohet që pjesa tjetër e nevojave plotësohen nga importi. Kurse, konsumi mesatar për kokë banori ishte mesatarisht rreth 3.5 kg për vit..


Figura 58: Furnizimi me elb dhe elb birre, 2021-2023



Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Përgjatë vitit 2023, u prodhuan 1,462 tonë me thekër, u importuan 280 tonë, ndërsa eksporti ishte i vogël prej vetëm 1 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për thekrës me prodhim vendor ishte 84%, apo 7 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2022, dhe 1 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2021. Pjesa tjetër e thekrës e nevojshme për të plotësuar nevojat për konsum por edhe përdorim tjetër mbulohet nga importi. Konsumi për kokë banori ishte mesatarisht më pak se 0.5 kg për vit, përgjatë gjithë periudhës '21-'23.

Figura 59: Furnizimi me thekër, 2021-2023




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

5.2 Konsumi për kokë banori

Gjatë periudhës '21-'23, konsumi mesatar i drithërave vlerësohet të jetë rreth 196 kg në vit për kokë banori. Nga pesë drithërat që kultivohen në Kosovë në sipërfaqe më të madhe, konsum më të lartë masatar për kokë banori në periudhën '21-'23 ka gruri me 179 kg në vit, pasuar nga misri me 13 kg, elb dhe elb birre me rreth 3.5 kg, tërshëra dhe thekra me më pak se 0.5 kg konsum për vit për kokë banori.

Figura 60: Konsumi i drithërave për kokë banori, 2021-2023



Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Konkluzionet

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është që të shqyrtohen në mënyrë të përmbledhur përmes të dhënave statistikore dhe analizave ekonomike zhvillimet në sektorin e drithërave në periudhën '21-'23, me fokus të veçantë në kulturën e grurit dhe misrit, kultura që edhe sipas sipërfaqeve të mbjella por edhe sipas sasisë të prodhimit dhe të konsumit janë kulturat më të rëndësishme bujqësore që kultivohen në Kosovë.

Në Republikën e Kosovës prodhimi i drithërave është komponentë kryesore e bujqësisë, ku sipërfaqet e prodhimit zënë 125 mijë hektarë, apo mbi një çerek të sipërfaqeve bujqësore në Kosovë. Ka pasur përmirësime në përdorimin e inputeve cilësore dhe teknologjike, mirëpo prodhimi dhe rendimenti prapë është ndikuar nga faktorët klimatik dhe faktorë të tjerë.

Tek tregtimi i drithërave duket se vitin e fundit ka rënie të importit në vlera, mirëpo Kosova mbetet një importuese e drithërave, veçmas e grurit dhe misrit. Importet janë të larta edhe të produkteve të industrisë blujatëse që si bazë kanë drithërat. Eksportet janë të kufizuara dhe janë kryesisht produkte të përpunuara. Këta indikator nxorën në pah nevojën për rritjen e prodhimit, konkurrueshmërin dhe përmirësimin e zinxhirit të vlerës.

Çmimet e kulturave të drithërave në vitin 2023, kanë shënuar rënie në raport me vitin 2022, vit ku kishte kriza të ndryshme në botë. Këto luhatjet (ulje-ngritje) të çmimeve janë të ndikuara nga varësia prej tregjeve ndërkombëtare dhe nga luhatjet e kostove të inputeve. Këta faktorë të jashtëm e bëjnë tregun e brendshëm të ndjeshëm ndaj krizave të furnizimit dhe rrjedhimisht edhe të çmimit.

Mbështetja institucionale për kulturat e drithërave bëhet përmes PPD-së dhe realizohet për sipërfaqet e mbjella, rendimentin (grurë dhe farë gruri) inpute: pleh dhe naftë. Mbështetja ka për qëllim rritjen e prodhimit si dhe motivimin e fermerëve për rritjen e sipërfaqeve të mbjella. Në vazhdimësi masat mbështetëse duhet rishikuar dhe orientim të skemave mbështetëse për nxitjen e prodhimit të qëndrueshëm dhe rritjen e rendimentit.

Plotësimi i nevojave për konsum gjatë periudhës '21-'23 është mesatarisht 74%, pavarësisht që Kosova është afër vetëmjaftueshmërisë nuk plotësohen të gjithë nevojat e konsumit, dhe rrjedhimisht kjo e bënë Kosovën të varur nga importi i drithërave. Varësia sado e vogël nga importet e bënë vendin të cenueshëm për sigurimin e ushqimit në rast të krizave të ndryshme.

Forcimi i sektorit të drithërave në Kosovë është një domosdoshmëri, ku përfshirja e palëve të ndryshëm në investime në mekanizëm, teknologji, zhvillim të njohurive, rishikim të politikave mbështetëse, zgjerim të kapaciteteve përpunuese si dhe zhvillim të tregut, janë komponentë që do të mund të sjellin ndryshime pozitive. Përmes një angazhimi të koordinuar të fermerëve dhe institucioneve të vendit, do të mund të arrihet vetëmjaftueshmëria dhe zhvillimi i qëndrueshëm i këtij sektori jetik të bujqësisë.

Shtojca 1

Tabela 22: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për grurë

CN	Përshkrimi	LLOJI	Koeficienti
10011100	Grurë i fortë (Durum) për farë	I papërpunuar	1
10011900	Grurë i fortë (Durum) (përveç atij për farë)	I papërpunuar	1
10019110	Spelt për farë	I papërpunuar	1
10019120	Grurë i zakonshëm dhe meslini, për farë	I papërpunuar	1
10019190	Farë gruri për mbjellje (përveç durum, grurit të zakonshëm dhe spelt)	I papërpunuar	1
10019900	Grurë dhe meslin (përveç atij për farë dhe grurit durum)	I papërpunuar	1
11010011	Miell prej gruri i fortë	Faza e parë e procesimit	1.37
11010015	Miell prej grurit të zakonshëm dhe spelt	Faza e parë e procesimit	1.37
11031110	Bullgur dhe kokërriza nga gruri durum	Faza e parë e procesimit	1.5
11031190	Bullgur dhe kokërriza nga gruri i zakonshëm dhe spelti	Faza e parë e procesimit	1.37
11032060	Aglomeruar në formë sferash nga gruri	Faza e parë e procesimit	1
11041910	Kokrra gruri të rrumbullakosura ose të petëzuara	Faza e parë e procesimit	1
11042951	Kokrra drithi nga grurit, të copëtuara dhe jo të punuara në ndonjë mënyrë tjetër	Faza e parë e procesimit	1
11042981	Kokrra gruri, të fetëzuara, të zhveshura, ose të punuara ndryshe (përveç atyre të rrumbullakosura, të petëzuara, miellit, atyre në formë sferash, të zhveshura, të kokërrzuara, dhe të papunuara në ndonjë mënyrë tjetër pos copëtimit)	Faza e parë e procesimit	1
11043010	Embrion i grurit, i plotë, i rrumbullakosur, i fetëzuar ose i grimcuar	Faza e parë e procesimit	0.75
11071011	Malt gruri në formë mielli (përveç atij të pjekur)	Faza e parë e procesimit	1.78
11071019	Malt gruri në (përveç atij në formë të miellit dhe të pjekur)	Faza e parë e procesimit	1.33
11081100	Nisheste gruri	Faza e parë e procesimit	1.69
11090000	Glutën gruri, qoftë i tharë ose jo	Faza e parë e procesimit	2.3

Tabela 23: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për misër

CN	Përshkrimi	LLOJI	Koeficienti
10051013	Misër hibrid tre-kryqëzime, farë për mbjellje	I papërpunuar	1
10051015	Misër hibrid i thjeshtë, farë për mbjellje	I papërpunuar	1
10051018	Misër hibrid, farë për mbjellje (përveç farave tre-kryqëzime dhe hibrid)	I papërpunuar	1
10051090	Misër për mbjellje (përveç hibridit)	I papërpunuar	1
10059000	Misër (përveç farës për mbjellje)	I papërpunuar	1
11022010	Miell misri, me përmbajtjeje yndyre jo më tepër se 1.5 %, sipas peshës	Faza e parë e procesimit	1.4
11022090	Miell misri, me përmbajtjeje yndyre > 1.5%, sipas peshës	Faza e parë e procesimit	0.45
11031310	Bollgur dhe kokrriza nga misri (si drithë), "corn", me përmbajtjeje yndyre jo më tepër se 1.5 %, sipas peshës	Faza e parë e procesimit	1.37
11031390	Bollgur dhe kokrriza nga misri (si drithë), "corn", me përmbajtjeje yndyre > 1.5%, sipas peshës	Faza e parë e procesimit	1.37
11032040	Aglomeruar në formë sferash nga misri	Faza e parë e procesimit	1
11041950	Kokrra misri të rrumbullakosura ose të petëzuara	Faza e parë e procesimit	1
11042340	Kokrra misri të zhveshura, madje edhe të fetëzuara apo copëtuara; kokrra misri të kokërrzuara	Faza e parë e procesimit	1
11042398	Kokrra drithi të fetëzuara, të copëtuara ose të punuara ndryshe (përveç atyre të rrumbullakosura, të petëzuara, të zhveshura, të kokërrzuara, atyre në formë sfere dhe miellit)	Faza e parë e procesimit	1
11043090	Embrion i drithit, i plotë, i rrumbullakosur, i fetëzuar ose i grimcuar (përveç grurit)	Faza e parë e procesimit	0.3
11081200	Nisheste misri (si drithë)	Faza e parë e procesimit	1.51

Tabela 24: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për elb

CN	Përshkrimi	LLOJI	Koeficienti
10031000	Elb, farë për mbjellje	I papërpunuar	1
10039000	Elb (përveç farës për mbjellje)	I papërpunuar	1
11029010	Miell elbi	Faza e parë e procesimit	1.37
11031920	Bollgur dhe kokrriza nga thekra apo elbi	Faza e parë e procesimit	1.37
11032025	Aglomeruar në formë sferash nga thekra ose elbi	Faza e parë e procesimit	1
11041961	Kokrra elbi të rrumbullakosura	Faza e parë e procesimit	1
11041969	Kokrra elbi të petëzuara	Faza e parë e procesimit	1
11042904	Kokrra elbi të zhveshura, madje edhe të fetëzuara apo copëtuara	Faza e parë e procesimit	1
11042905	Kokrra elbi të kokërrzuara	Faza e parë e procesimit	1
11042908	Kokrra drithi të fetëzuara, të copëtuara ose të punuara ndryshe (përveç atyre të rrumbullakosura, të petëzuara, të zhveshura, të kokërrzuara, atyre në formë sferë dhe miellit)	Faza e parë e procesimit	1
11071091	Malt në form mielli (përveç atij të pjekur dhe të grurit)	Faza e parë e procesimit	1.27
11071099	Malt (përveç atij të pjekur të grurit dhe atij në formë të miellit)	Faza e parë e procesimit	1.27
11072000	Malt i pjekur	Faza e parë e procesimit	1.49

Tabela 25: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për tërshërë

CN	Përshkrimi	LLOJI
10041000	Tërshërë, farë për mbjellje	I papërpunuar
10049000	Tërshërë (përveç farës për mbjellje)	I papërpunuar

Tabela 26: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë për thekër

CN	Përshkrimi	LLOJI
10021000	Thekër, farë për mbjellje	I papërpunuar
10029000	Thekër (përveç farës për mbjellje)	I papërpunuar